



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 906 Prot.

Tiranë, më 07.2.2014

UDHËZIM

Nr. 3, datë 07.2.2014

PËR

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.60, DATË 26.12.2013 " PËR ZHVILLIMIN E
PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2014**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 26 të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006 "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe provimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit Ministrave, nr. 1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)",

U D H Ë Z O J:

1. Pika 1. e Udhëzimit nr.60, datë 26.12.2013 "Për zhvillimin e Provimeve të Maturës Shtetërore ndryshon si më poshtë :
"1.1 Testi i gjuhës së huaj të hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të shkollës së mesme të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.
1.2 Menyja e gjuhëve të huaja si provim i detyruar është : anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht.
1.3 Testi i gjuhës së huaj si provim i detyruar do të hartohet nga AKP dhe provimi do të administrohet dhe vlerësohet nga DAR/ZA-të përkatëse."
2. Germa c. e pikës 3 ndryshon si më poshtë :
"c. Maturanti ka të drejtë të zgjedhë gjuhën e huaj, të cilën parapëlqen, pavarësisht nëse e ka zhvilluar ose jo në shkollë, në nivelin gjuhësor B2. Lista e gjuhëve si lëndë me zgjedhje të detyruar përcaktohen në udhëzimin për plotësimin e formularit A1/A1Z."

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Komiteti i Maturës Shtetërore, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Arsimore dhe Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

LINDITA NIKOLLA


MINISTËR

